REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 155/17
Datë/Datum. 13.06.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr. 155/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Goran Milenković – Kryetar, z. Tefik Sylejmani- Referues, z. Nuhi Paçarizi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik N.T.P "Yess Pharma"s - Prishtine, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me Skaner X-Ray dhe detektor", me numër të prokurimit 2017/214/17/701/121. iniciuar nga AK-/Ministria e Puneve te Brendshme/ më datën 12.06.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet** , pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik N.T.P "Yess Pharma"s - Prishtine lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Skaner X-Ray dhe detektor", me numër të prok: 2017/214/17/701/121. iniciuar nga Autoriteti Kontraktues / Ministria e Punëve te Brendshme /.

II. **Anulohet,** vendimi për dhënie të kontratës i AK-/ Ministria e Punëve te Brendshme /, lidhur me aktivitetin të prokurimit, me titull: "Furnizim me Skaner X-Ray dhe detektor", me numër të prok: 2017/214/17/701/121 dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar

dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "N.T.P "Yess Pharma" - Prishtinë, aprovohet pjesërisht, i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:13.03.2017

Hapja e ofertave është bërë me dt:07.04.2017, ku kanë marr pjesë katër operator ekonomik.

Njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me ketë aktivitetit të prokurimit është bërë me dt:15.05.2017, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "Tektroniks&Elting" Prishtinë.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik N.T.P "Yess Pharma" - Prishtine me dt: 17.05.2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 19.05.2017 autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik, N.T.P "Yess Pharma" – Prishtine.

Operatori ekonomik ankues N.T.P "Yess Pharma" - Prishtine, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 25 maj 2017 me nr. 155/17 kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Skaner X-Ray dhe detektor", me numër të prok: 2017/214/17/701/121, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues "MPB" duke pretenduar se autoriteti kontraktues, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, ka bërë shkelje të këtyre dispozitave të LPP-së.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet 56 pika 1.1, 1.2 të Ligjit për

Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

- Po ashtu Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim edhe me nenin 59 paragrafi 4 të Ligjit për Prokurimin Publik

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 01.06.2017 ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertët Shqyrtues në raportin e dt: 08.06.2017 bazuar në sqarimet e cekura në raport konstaton se Autoriteti Kontraktues – MPB, për aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Skaner X-Ray dhe detektor", me numër të prok: 2017/214/17/701/121, nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së. Prandaj eksperti shqyrtues i propozon panelit që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, ndërsa të anulohet vendimi i AK-MPB për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Me 08.06.2017 përmes parashtresës OE ankues e njofton panelin se të njëjtit pajtohen me raportin e ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 12. 06. 2017, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, përfaqësuesi i OE ankues, eksperti i OSHP-së, eksperti teknik, Vëzhgues nga D Plus, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE: "Yess Pharma" z.Tahiri deklaroj: Ne pasi kemi bërë ankesën kemi pranuar njoftimin prej ekspertit, pajtohemi me gjitha pikat përveç pikës te detektori metalik, ku ankesa jonë është konsideruar e paqëndrueshme. Te kjo pikë për qëllim kemi pas te përzirja metaleve, pajisja që ka ofruar OE i rekomanduar për kontratë e ka mundësinë për të detektuar metalet magnetike dhe jo magnetike mirëpo jo edhe "Mixed Alloys" apo metale të përziera.
Po ashtu te e njëjta pajisje është dashtë të ketë RS422, RS 232, ose RS485. Në broshurën e prodhuesit për të njëjtën pajisje nuk figuron ky opsion, mirëpo i njëjti prodhues ka pajisje me po këtë opsion që është e palogjikshme, pasi me njëjtën broshurë e ka opsionin ndërsa në tjetrën broshurë nuk e ka. Me gjitha pikat tjera të raportit jemi pajtuar.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-MPB z.Islami deklaroj: MPB pajtohet me disa pika të ekspertizës, përveç me konstatimin 1, 2 dhe 5.
Ne kundërshtojmë mendimin e ekspertit, për arsye se kërkesa e AK-së ka qenë kërkesë minimale, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar pajisje me kapacitet më të lartë se minimumi i kërkuar nga ne.
Gjithashtu pajisja që ka ofruar OE i rekomanduar për kontratë është me mundësinë e akordimit-e akordueshme, që do thotë se ka mundësinë për rritje-zvogëlim të shiritit transportues.
Andaj edhe për këtë pikë qëndrojmë pranë vendimit të AK-së.
Për pikën 2, është tek pozicioni "Detection Resolution", kemi kërkuar që rezolucioni të jetë 40 deri 41.
Pas sqarimeve shtesë që kemi kërkuar nga OE, ai ka konfirmuar se pajisja është në përputhje me kërkesat tona. Këto sqarime do përdoren edhe gjatë pranimit të paisjes.
Konstatimet e ekspertit, konstatimi 3 pajtohemi me konstatimin e ekspertit pasi kjo kompani ka ofruar pajisje që detekton metalet veç e veç dhe të përziera mirëpo nuk jep sqarim si e kërkon OE ankues, pra jep variant tjetër të detektoj dyja bashkë.
Te konstatimi tjetër pajtohemi me konstatimin për RS 232, dhe kundërshtojmë pretendimin e OE ankues për shkak se edhe broshura e OE ankues modeli i njëjtës pajisje ka disa broshura të ndryshme me specifika të ndryshme, andaj nuk qëndron pretendimi i OE ankues.
Konstatimi 5, kundërshtojmë mendimin e ekspertit për arsye se është një kërkesë-fjali e cila nuk ka ndonjë rëndësi për pajisjen Detektor i Dorës. Përshkrimi HHMD që eksperti pretendon se nuk është, kjo është një shkurtesë që i bie Hand Held Metal Detector.
Kjo është një pajisje që fabrikisht montohet për detektim dhe nuk ka diçka të veçante për konfigurim, përveç që ka manipulatorin për vibrim, me zë, ose dyjat bashkë, dhe nuk ka tjetër çka të konfigurohet.
Përveç kësaj OE i rekomanduar për kontratë është OE me çmimin më të ulët dhe plotëson gjitha kërkesat e AK-së, andaj i rekomandojmë panelit që ankesa e OE ankues të hedhet e pabazuar, dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues z.Spahiu deklaroi: Me qëllim kam përshkruar në raport në mënyrë përshkruese çka është kërkuar, çka është ofruar dhe cilat janë evidencat në broshura.
Është kërkuar minimal 680, ndërsa në pyetje të OE-se se a mund të jetë më e lart, AK ka thënë po **lejohet deri** në 700.
Ndërsa oferta e OE të rekomanduar për kontratë thotë se është 806.
Gjithashtu në broshurë nuk evidentohet se ky produkt është i akordueshëm "Adjustable".
Pika dytë, është një kërkesë me dy parametra. thotë "resolution 40AËG gurarante. 41 AVG typical". Ndërsa produkti i ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë e ka resolution 38AËG gurantëë 40 AVG typical. Kjo shihet se numrat nuk përputhen mes kërkesës dhe asaj çka ka ofruar OE fitues.

Mospajtimi i OE ankues lidhur me detektimin e metaleve të përziera magnetike dhe jo magnetike, nëse shikohet broshura produktit aty përcaktohet se fushëveprimi i detektimit përfshinë metalet me ngjyrë dhe metalet pa ngjyrë. Nëse shikojmë përbërjen fizike kimike të metaleve është evidente se këtu përfshihen pjesët magnetike të detektimit.
Është kërkuar RS232, unë në broshurë zyrtare të produktit e kam gjetur se ky funksion është opcional, dhe rrjedhimisht OE i rekomanduar për kontratë e ofron edhe këtë opsion.
Kërkesa PD140N customisable HHMD konfiguration tool, në këtë rast nuk është kërkuar funksioni siç tha AK, mirëpo është kërkuar specifikisht një përshkrim i funksionit të një produkti. PD140N është emër i produktit të cilin e oferton vetëm OE ankues dhe rrjedhimisht nuk ka mund të ofroj OE i rekomanduar.
Mospërputhjet mes specifikimit dhe asaj që ofrohet janë evidente, mirëpo kam dhënë edhe sqarim se kjo nuk përmban pengesë funksionale me qëllimin për të cilin shërben produkti.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i OE:"Yess Pahrma" z.Tahiri deklaroj: I propozojmë panelit shqyrtues që të aprovohet ankesa jonë si e bazuar dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i AK –MPB z.Islami deklaroj: Qëndrojmë pranë vendimit të AK dhe i rekomandojmë panelit të njëjtin ta vërtetoj si të bazuar dhe të refuzohet ankesa e OE ankues si e pabazuar.

Në fund eksperti z.Spahiu deklaroj: Qëndroj pranë raportit të ekspertizës dhe konstatimeve të dhëna në ekspertizë.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues të cekur në ekspertizë, parashtresave të palëve në procedurë, deklarimit të OE ankuese ne seancë lidhur me ekspertizën, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton se Autoriteti Kontraktues / Ministria e Punëve të Brendshme / me rastin e vlerësimit të ofertave nuk e ka respektuar nenin 59 të LPP-së, për faktin se autoriteti kontraktues tek informatat sqaruese ka specifikuar se lartësia e shiritit transportues mund të jetë deri në 700 mm ndërsa operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë e ka ofruar lartësinë e shiritit transportues prej 806 mm duke e rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar kërkesat e AK-së të parashikuara në FDT. Këtë fakt e ka sqaruar edhe eksperti teknik në raportin e tij.

Paneli shqyrtues konstaton se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e ka plotësuar kërkesën e AK-së në lidhje me skanerin pasi që për pjesën detection charachteristics ka specifikuar resolution 40 AWG guaranteed, 41 AWG typical, ky operator ekonomik ka ofruar produktin me resolution 36 AWG guaranteed, 38 AWG typical.

Paneli shqyrtues sqaron se në dosje të tenderit tek përshkrimi teknik i detektorit të dorës pjesa detection and operational functions është kërkuar customizable via HHMD configuration tool, ndërsa operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka ofruar broshurën e produktit ku nuk specifikohet askund kjo kërkesë apo ndonjë funksion ekuivalent, prandaj për këtë arsye ky OE konsiderohet i papërgjegjshëm.
Paneli shqyrtues vjen në përfundim se autoriteti kontraktues me rastin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve nuk e ka respektuar nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së duke mos u trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë ofertuesit.
Paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave të ju përmbahet të gjitha dispozitave të LPP-së dhe posaçërisht të ketë parasysh edhe nenin 1 dhe 6 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Ministria e Punëve te Brendshme "

1x1 OE N.T.P "Yess Pharma" Prishtine

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.